



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 24 maj 2017

Numri i lëndës: 2017-07

C.X.

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 24 maj 2018, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar në Panel me datën 11 tetor 2017.
2. Ankuesi ka kërkuar që Paneli mos t'i bëjë publike të dhënat e identitetit të tij. Në bazë të rrethanave të lëndës, Paneli ka miratuar kërkesën në fjalë.

II. FAKTET

3. Faktet e lëndës, siç janë paraqitur nga ankuesi dhe siç paraqiten në dokumentet në dispozicion të Panelit, mund të përmbliidhen si më poshtë:
4. Më 13 shtator 2010, ankuesja dhe gjashtë të pandehur të tjerë ishin akuzuar nga Prokuroria Speciale e Kosovës për krim të organizuar dhe kontrabandim të emigrantëve.
5. Aktakuza ishte vërtetuar nga gjyqtari konfirmues i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë më 20 tetor 2010.
6. Më 17 qershor 2011, një trup gjykues i përzier i EULEX-it dhe gjyqtarëve të Kosovës kanë lëshuar aktgjykim lidhur me këtë rast. Ankuesi ishte shpallur fajtor për pjesëmarrje në një grup të organizuar kriminal në lidhje me kontrabandimin e emigrantëve dhe e kishte dënuar atë me nëntëmbëdhjetë vjet burgim. Gjithashtu ai ishte gjobitur me 250,000 euro. Ankuesi dhe bashkë i pandehuri janë ankuar ndaj këtij aktgjykimi.
7. Më 2 tetor 2012, Gjykata Supreme në një përbërje të trupit gjykues të përzier nga gjykatës të EULEX-it dhe gjykatës të Kosovës dhe kryesuar nga një gjykatës i EULEX-it kanë hedhur poshtë të gjitha ankesat dhe kanë vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.
8. Më 2 tetor 2012, Gjykata Supreme në një përbërje të një trupi gjykues të përzier prej një gjykatësi të EULEX-it dhe dy gjykatësve të Kosovës kishin hedhur poshtë kërkesën e ankuesit dhe të bashkë të pandehurit për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar.

III. ANKESAT

9. Pa përmendur ndonjë dispozitë të caktuar të instrumenteve për mbrojtjen e të drejtave të njerit, ankuesi pohon se ishte dënuar padrejtësisht dhe proteston për pafajësisë së vet. Për nga përmbajtja e ankesës së tij, duket se ai pretendon në shkelje të të drejtave të tij për gjykimin të drejtë, *ndër të tjera*, të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenit 14 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

IV. LIGJI

10. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të zbatoj instrumentet e të drejtave të njeriut, siç pasqyrohen në Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.

11. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së punës.
12. Sipas rregullës 25, paragrafi 1 i rregullores së punës, Paneli mund t'i shqyrtoj ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në gjyqësi, polici dhe dogana.
13. Paneli në shumë raste ka konstatuar se, sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së punës, bazuar në konceptin e llogaridhënies së OPLAN-it të EULEX-it Kosovë, në parim Paneli nuk ka kompetencë as mbi aspektet administrative e as mbi aspektet juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Fakti që gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues të ndonjë gjykate të caktuar, nuk do të thotë se ia humb asaj gjykate karakterin e të qenit pjesë e sistemit juridik të Kosovës (shih ndër të tjera *Shpresim Uka kundër EULEX-it*, 2016-06 & 2017-04, 17 tetor 2017, par. 22; *Z.A. kundër EULEX-it*, 2014-36, 29 shkurt 2016, par. 17; *K.P. kundër EULEX-it*, 2014-31, 21 prill 2015, par. 13; *Gani Zeka kundër EULEX-it*, 2013-15, 4 shkurt 2014, par. 13).
14. Vetëm nga ky fakt del se kjo ankesë nuk hyn në kuadër të mandatit të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të Rregullores së vet të Punës dhe OPLAN-it të EULEX-it Kosovë.
15. Paneli konstaton se veprimi rreth të cilit është bërë ankesa nga ankuesi bie jashtë afatit gjashtë mujor, brenda të cilit ankesa duhet të parashtrohet në Panel (Rregulla 22(3) e Rregullores së Punës). Vendimi i Gjykatës Supreme që e refuzon kërkesën e ankuesit për mbrojtje të ligjshmërisë ishte lëshuar më 2 prill 2014, ndërsa kjo ankesë është parashtruar në Panel më 11 tetor 2017, shumë kohë pasi kishte kaluar afati i zbatueshëm me datën 2 tetor 2014.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë që të shqyrtoj këtë ankesë, pasi ajo bie jashtë kompetencave të tij në bazë të nenit 29 (d) të Rregullores së vet të Punës dhe nuk është në përputhje me nenin 25(3) të Rregullores sa i përket afatit për paraqitjen e një ankese, dhe

SHBALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese